



10 nëntor 2021
Nr.Prot. 27

Drejtuar: **Z.Eduart Shalsi,**
Kryetar
Komisioni për Ekonominë dhe Financat
Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

Për Dijeni: **Znj.Delina Ibrahimaj**
Ministër
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

RE: Paketa Fiskale 2022

I nderuar Z. Shalsi,

E nderuar, Znj. Ibrahimaj,

Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri konsideron me rëndësi të madhe procesin e ndryshimeve mbi projektligjet për Paketën Fiskale 2022.

Në përgjigje të materialit që na është parashtruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi ndryshimet e reja ligjore, Dhoma Amerikane ju bën me dije se: së pari, një pjesë e madhe e bizneseve anëtare, kanë reaguar me shqetësim, në lidhje me këto projektligje; së dyti, koha e vënë në dispozicion të Dhomës Amerikane nuk ka qënë e mjaftueshme që grupet tona teknike të zhvillojnë një analizë të plotë për të prodhuar komente të detajuara për draftin.

Përsa më sipër, Dhoma Amerikane shpreh shqetësimin mbi procesin dhe përmbajtjen e projektligjeve si më poshtë:

- **Thyerja e angazhimit publik për një paketë fiskale të qëndrueshme me ndërhyrje të paktën njëherë në katër vjet.** Pasi komuniteti i biznesit ka shprehur shqetësimin e vazhdueshëm, mbi ndryshimet e shpeshta mbi paketën fiskale dhe tatimet, si dhe në përshtatje me praktikën më të mira botërore, zyrtarë të lartë duke përfshirë Ministrin e Financave, Kryeministrin, etj., janë angazhuar publikisht për ndryshime më pak frekvente të ligjit, njëherë në çdo 4-vjeçar. Për rrjedhojë, ky projektligj bie ndesh me angazhimet publike qeveritare, pritshmëritë dhe planifikimet financiare të komunitetit të biznesit dhe dëmton klimën e besimit reciprok mes sektorit publik dhe atij privat mbi angazhimet publike.
- **Shkelja e Përsëritur e Afateve të Ligjit mbi Konsultimin Publik.** Dhoma Amerikane vëren e zhgënjyer se u njoftua mbi projektligjet e paraqitur nga Këshilli i Ministrave mbi paketën fiskale 2022, pasi ato ishin miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe ishin depozituar pranë Kuvendit. Kjo praktikë – fatkeqësisht e përsëritur – është në shkelje të ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin publik”, i cili i kërkon autoriteteve shtetërore t’i ofrojnë palëve të interesuara një periudhë kohore të përcaktuar për të shqyrtuar dhe ofruar rekomandimet e tyre në lidhje me projektligjin/et e propozuar.



Për arsyet e mësipërme, **Dhoma Amerikane kërkon shtyrjen e afatit të projektligjeve**, nëpërmjet zbatimit të ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin publik”, duke i lënë mundësi grupeve të interesit të ushtrojnë të drejtën e tyre duke u njohur me përmbajtjen e ligjit dhe ofrimin e sugjerimeve për përmirësimin e tij. Në vijim, Dhoma Amerikane shpreh bindjen se projektligjet kanë nevojë për përmirësim, i cili do të mundësohej pas reflektimit të rekomandimeve të komunitetit të biznesit. Një pjesë e problematikës është e bashkëngjitur.

Gjithashtu, Dhoma Amerikane rekomandon nisjen nga puna për hartimin dhe konsultimin e një **Ligji të Ri për Tatimin mbi të Ardhurat**, që të **harmonizohet me standardet ndërkombëtare dhe kombëtare të kontabilitetit**. Periudha 4-vjeçare në dispozicion të një ligji të ri të tatimit mbi të ardhurat, do i jepte mundësi grupeve të punës të unifikonin taksimin e pagamarrësve dhe personave fizikë e tregtarë. Kjo ka qënë një kërkesë e vazhdueshme e komunitetit ndërkombëtar të biznesit, i cili do sillte një frymë të re në Investimet e Huaja Direkte, harmonizimin me standardet ndërkombëtare dhe krijimin e kushteve për uljen e informalitetit.

Ju falenderojmë për vëmendjen!

Me respekt,

Enio Jaço
President

Komente të Dhomës Amerikane të Tregtisë lidhur me Paketën Fiskale 2022

Komentet e mëposhtme janë propozuar nga anëtarët e Dhomës Amerikane të Tregtisë (“AmCham”) lidhur me projektligjet e propozuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (“MFE”) të cilat parashikohen të hyjnë në fuqi në vitin 2022 (“Paketa Fiskale 2022”).

Komentet e janë të ndara në dy seksione; në *seksionin I* përfshihen komentet në lidhje me ndryshimet e propozuara nga projektligjet specifike, ndërsa në *seksionin II* përfshihen rekomandime të tjera.

SEKSIONI I

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar

Projektligji propozon një skemë të re për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi si vijon:

E ardhura nga paga në lekë/muaj		E ardhura e tatueshme në lekë/muaj		Norma Tatimore në përqindje/mujore
Nga	Deri në	Nga	Deri në	
0	40,000	0	40,000	0%
40,001	50,000	0	30,000	0%
		30,001	50,000	50% * 13% të shumës mbi 30,000 lekë
50,001	Më tepër	0	30,000	0%
		30,001	200,000	13% e shumës mbi 30,000 lekë
		200,001	Më tepër	22,100 lekë + 23% të shumës mbi 200,000 lekë

Koment: Fashat e reja për llogaritjen e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi komplikojnë zbatimin e këtij tatimi dhe realisht nuk lehtësojnë barrën tatimore për pagat. Vendosja e tatimeve duhet të bazohet në disa parime që janë neutraliteti, efiçensa, qartësia, thjeshtësia, efektiviteti dhe barazia. Nëse i referohemi projektligjit të propozuar konstatojmë se asnjë nga këto parime nuk është ndjekur.

- Skema e propozuar është tepër e komplikuar, krijon vështirësi në llogaritje, e paqartë dhe prodhon evazion.
- Skema e propozuar thëllon pabarazinë ndërmjet tatimpaguesve që kanë nivel të njëjtë apo më të lartë të ardhurash, duke diskriminuar, pra tatuar vetëm tatimpaguesit me të ardhura nga pagat. Krahasuar me tatimpaguesit e regjistruar si persona fizikë që mund të kenë të njëjtin nivel apo shumë herë më shumë të ardhura, barra tatimore e përcaktuar për të punësuarit mbetet shumë e lartë. Praktika ka treguar se aplikimi i tatimit progresiv dhe mbajtja e një norme të pandryshuar gjatë 8 viteve të fundit ka rritur numrin e të vetëpunësuarve që më parë kanë qenë të deklaruar si të punësuar.



- Pavarësisht se zgjedhja e mënyrës së kontraktimit është e drejtë e çdokujt, realisht ka sjellë shmangie të ligjshme nga pagesa e tatimit mbi të ardhurat. Prezantimi i skemës së re dhe komplikimet që shoqërojnë zbatimin e saj, do të thellojë hendekun midis këtyre dy kategorive të tatimpaguesve dhe nuk sjell ndonjë përfitim në të ardhurat e buxhetit të shtetit.
- Duke marrë në konsideratë dhe të ardhurat e tjera personale që kanë në natyrë pasive si dividendi, interesi, qiraja shohim një pabarazi të theksuar në shkallën tatimore krahasuar me pagat.
- Formula e re e llogaritjes së tatimit nga pagat është tepër e komplikuar duke pasur parasysh se kemi 3 intervale të ardhurash dhe përkatësisht 1, 2, 3 shkallë tatimore brenda nivelit. Në kushtet që në Shqipëri llogaritja e pagave nuk është e automatizuar ndryshimi rrit vështirësinë në llogaritje dhe kohën e nevojshme për të llogaritur dhe paguar pagat. Propozuesit nuk kanë marrë parasysh faktin se përditësimi i mënyrës së llogaritjes dhe arritja e një llogaritje të saktë është e kushtueshme për bizneset, në veçanti ato me një numër të madh punonjësish apo për ato të cilat kanë lidhur kontrata në bazë neto të pagës.
- Përjashtimi që jepet për fashën e pagave deri në 40,000 Lekë mendojmë që duhet të aplikohet në mënyre uniforme në të gjitha intervalet dhe të mos ketë diferencime. E paqartë është arsyeja dhe duket e padrejtë që niveli i tatimit prej 0% të mos jetë i zbatueshëm për të gjitha kategoritë njëloj. Përfitimi është shumë i vogël dhe vetëm për kategorinë 40-50 mijë lekë (për max 1,300 lekë/muaj) dhe kategorinë mbi 150 mijë lekë (për max 5,000 lekë/muaj). Ndërkohë që pagat e mesme nga 60 në 150 mijë lekë nuk kanë asnjë përfitim. Prandaj edhe ne do të sugjeronim që progresiviteti të shtrihej me fasha më tej dhe me norma të ndërmjetme.
- Duke mbajtur parasysh që rritja e pragut të patatueshëm zakonisht shoqërohet dhe me rritje të pagës minimale në shkallë vendi për një kategori të madhe të punonjësve, tatimi i ri jep një efekt negativ nëse llogarisim nivelin e ri të sigurimeve shoqërore që nuk rimbursohet apo neutralizohet nga ndryshime të tjera ligjore. Rritja e pagës minimale në fillim të 2021 ka rritur barrën e kontributeve dhe ka pasur efekt negativ përgjatë këtij viti dhe përpos kësaj, një rritje tjetër në fillim apo mes të 2022 dhe ndryshimi i metodës së tatimit mbi pagat pritet të japë përsëri një efekt negativ në të ardhurat neto të punonjësve në shkallë vendi.
- Fashat e reja nuk marrin parasysh të ardhurat me karakter sezonal. Kjo pasi tatimi për llogaritjet për të ardhura mujore dhe jo vjetore. Pra një punonjës sezonal që të ardhurat mund t'i realizojë për 3 muaj brenda vitit, për të njëjtat të ardhura, paguan më shumë tatim sesa një punonjës që të njëjtat të ardhura i shpërndahen në 12 muaj. Ky është një problem që ka ekzistuar edhe më parë me prezantimin e tatimit progresiv.

Propozime:

- a) Lidhur me sa më sipër propozojmë që mos të ketë progresivitet brenda fashave pasi kjo do të sillte shtrembërim të pagave reale me qëllimin për të mos kaluar në një fashë tjetër të tatimit.
- b) Shohim të nevojshme ndryshimin e metodës së tatimit të të ardhurave nga punësimi në baza vjetore dhe jo mujore. Tatimi mbi të ardhurat personale, nëse do të mbahet progresiviteti duhet të jetë me bazë vjetore (shembull Kosova). Tatimi mund të llogaritet dhe mbahet në baza mujore por është e detyrueshme që të bëhet dhe rregullimi në fund të vitit, përmes deklaratës vjetore.
- c) Do të propozonim që tatimi në shkallën 6.5% të fillojë të aplikohet në mënyrë uniforme për intervalin e pagave 40,001 Lekë deri në një pagë deri në 100,000 Lekë në muaj dhe për pagat mbi 150,000 Lekë të taten me jo me shumë se 18%.



2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 61/2012 ‘Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar”

- a) Projektligji propozon shfuqizimin e shkronjës (d) të nenit 14 “Rimbursimi”, nëpërmjet të cilit synohet “heqja e rimbursimit për lëndët djegëse të konsumuara në serat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë (farmaceutika, tullat, çimento, birra dhe nafta bruto).”

Koment: Në relacionin shoqërues për ndryshimin e propozuar, përcaktohet si më poshtë:

“Ky propozim vjen në kuadër të hartimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, ku Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), ka rekomanduar që të gjitha përjashtimet jo standarde, normat e reduktuara dhe trajtimet preferenciale duhet të eliminohen nga TVSH-ja, **akcizat dhe taksat kombëtare**”.

Gjatë komunikimit me përfaqësues të Ministrisë së Financës kuptuam që rimbursimi i akcizës për lëndët djegëse të konsumuara në serat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale, konsiderohet nga ana e qeverisë shqiptare **si një përjashtim jo standard ose si një trajtim preferencial** dhe në këtë kuadër sikurse nisur edhe nga rekomandimet e FMN, do të duhet të hiqet. Në fakt, rimbursimi i akcizës nuk mund të klasifikohet në grupin e përjashtimeve jo standarte apo trajtimeve preferenciale, siç do të shpjegojmë më poshtë. Gjithashtu, dëshirojmë të risjellim në vëmendjen tuaj efektin e dukshëm negativ që ka akciza, si një prej taksave indirekte në procesin e prodhimit të cimentos, sa i takon konkureshmërisë së këtij produkti vendas dhe potencialit të kësaj industrie për eksport.

Ligji nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ka përafuar këto akte të BE-së: Direktivën e BE-së nr. 2008/118; **Direktivën e Këshillit 2003/96/ të datës 27 Tetor 2003**; Direktivën 92/83/KEE e datës 19 tetor 1992; Direktivën 92/84/KEE e datës 19 tetor 1992; Direktivën 92/12/EEC e 25 shkurt 1992; Vendimin e Komisionit nr. 428 datë 22.06.2006; Rregulloren e Komisionit EC 2008/450.

Direktiva e Këshillit 2003/96/ të datës 27 Tetor 2003, sikurse është transpozuar në ligjin shqiptar por dhe në të gjitha legjislacionet europiane dhe ato të rajonit, sa i takon akcizës për produkte energjitike të përdorura në procese mineralogjike, parashikon **PËRJASHTIM nga pagesa e akcizës**.

Në të njëjtën kohë edhe Ligji nr. 61/2012 datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë” Neni 10 Rastet e përjashtimeve pika 3 përmban parashikime identike:

“Neni 10”

Rastet e përjashtimeve

[...]

3. Përfitojnë **përjashtim** nga pagesa e akcizës edhe:

[...]

c) produktet energjetike me përdorim të dyfishtë. Një produkt është me përdorim të dyfishtë kur është i destinuar njëkohësisht si lëndë djegëse dhe për përdorim të ndryshëm nga ai i karburanteve ose i lëndëve djegëse. Përdorimi i produkteve energjetike për reduktimin kimik dhe elektrolizën, si dhe procese metalurgjike konsiderohen si një përdorim i dyfishtë;

ç) **produktet energjetike të përdorura në proceset mineralogjike;**”



Ky parashikim i Ligjit nr. 61/2012 datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë” është tërësisht në përputhje me Direktivën e BE-së 2003/96/KE datë 27 Tetor 2003 *ristrukturimi i kornizës së Komunitetit për taksimin e produkteve energjetike dhe elektricitetin*^[1] Neni 2 pika 4 shkronja (b) paragrafi pesë i cili parashikon shprehimisht:

“procese mineralogjike janë proceset të cilat klasifikohen në Nomenklaturën NACE nën kodin DI 26 “fabrikimi i artikujve të tjerë minerale jo metalike” në Rregulloren e Këshillit (EEC) Nr. 3037/90 datë 9 Tetor 1990 mbi klasifikimin statistikor të aktiviteteve ekonomike në Bashkimin Europian”. Nomenklatura NACE sipas Rregullores së Këshillit (EEC) Nr. 3037/90 është tranzpozuar në legjislacionin Shqiptar me VKM nr. 327 datë 18.7.1994 “Për miratimin e zbatimit të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike”^[2] dhe Nënseksioni DI 26 *Fabrikimi i artikujve të tjerë minerale jo metalike*, ndër të tjera, përfshin **26.5 Fabrikimi i çimentos, gëlqeres, dhe allçisë etj.**

Në kundërshtim me sa më lartë, nga viti 2012 kur Ligji nr. 61/2012 datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë” është miratuar e deri aktualisht, në zbatim të gabuar të parashikimeve ligjore, industrisë përpunuese Shqiptare të prodhimit të produkteve minerale jo metalike i është mohuar padrejtësisht e drejta ligjore për të përfituar **përijashtim** nga akciza e produkteve energjetike të përdorura në procese mineralogjike, sikurse kanë përfituar dhe vazhdojnë të përfitojnë konkurrentët në rajon dhe në Bashkimin Europian.

Rrjedhimisht, akciza e paguar, ndër të tjera, për koksin e naftës së prodhuar në vend ka dëmtuar industrinë përpunuese Shqiptare të prodhimit të produkteve minerale jo metalike, pasi prodhuesit e çimentos edhe në Republikën e Shqipërisë do duhej të ishin **përijashtuar** nga akciza, në përputhje me bazën ligjore të sipërcituar.

Sa më lart, mundësia e rimbursimit të akcizës në masën 50% që aplikohet sot, në asnjë rast nuk përbën një përijashtim jo standard apo trajtim preferencial për industrinë e çimentos, sikurse konsiderohet nga qeveria shqiptare, por thjesht dhe vetëm një mekanizëm gjysmak, i cili ndryshe nga sa udhëzon direktiva në fjalë dhe modelet e rajonit e ato të vendeve europiane, e ka venë në mënyrë të vazhdueshme në disavantazh këtë industri duke i mohuar përfitimin legjitim të saj.

Industria e çimentos në mirkuptim të nevojave të buxhetit të shtetit ka ndihmuar, duke pranuar të jetë në rolin e kreditorit (fillimisht kur rimbursimi mundësohej në masën 100%) e më pas edhe në atë të kontributorit në masën 50% (kur rimbursimi filloi të mundësohej në masën 50%). Nëse edhe kjo mundësi rimbursimi synon që të eliminohet, ndërkohë që pretendohet që në kundërshtim të të drejtave të kësaj industrie për përijashtim nga akciza (sipas ligjit dhe direktivës përkatëse), kjo industri të paguajë në mënyrë të pakthyeshme akcizë për lëndët e ngurta djegëse që përdoren në procesin e saj teknologjik në masën 100%, kjo do të godiste seriozisht konkurrueshmërinë e këtij produkti vendas dhe do të dërgonte një mesazh dekurajues për këtë industri e cila deri më tani, në frymën e mirëkuptimit dhe të partneritetit, ka lënë mënjanë pretendimin e saj legjitim për përijashtim të plotë nga akciza sipas ligjit.

Dëshirojmë të theksojmë se kosto e lëndës djegëse e ngurtë që kjo industri përdor në procesin e saj prodhues, varion nga 20-35% të kostos totale të prodhimit. Taksat indirekte (taksa e Karbonit dhe ajo e Akcizës) janë të barabartë me 80% të vlerës së lëndës djegëse para taksimit, ndërkohë që industria synon që rreth 50% të prodhimit ta destinojë për eksport.

[1] Council Directive 2003/96/EC of 27 October 2003 restructuring the Community framework for the taxation of energy products and electricity

[2] <http://ëëë.instat.gov.al/al/dokumentimi/klasifikime-nomenklatura/>

Sa më lart, në frymën e përafrimit të legjislacionit Europian dhe për rrjedhojë atë të krijimit të kushteve sa më konkurruese e minimalisht të barabarta me ato ekzistuese në rajon si dhe në vendet europiane, kërkojmë që deri në përjashtimin e plotë të Akcizës sipas Ligjit, mundësia e rimbursimit të akcizës në masën 50% të mos hiqet e njëkohësisht të konsiderohet mundësimi i rimbursimit të saj në masën 100% për produktet energjitike që përdoren në proceset mineralogjike ku bën pjesë edhe industria e prodhimit të çimentos.

b) Diskriminimi i produkteve të importit kundrejt atyre vendase

Ekziston një shqetësim i madh midis industrisë sonë së produktet vendase të duhanit me shumicë, tatohen më pak se produktet e importuara, duke krijuar një pozicion diskriminues për produktet që tregtojmë. Si pjesë e rishikimit të legjislacionit tatimor dhe atij të duhanit, ne insistojmë që trajtimi i të gjitha produkteve të duhanit të barazohet. Një qasje e tillë do të përmbushte detyrimet e Shqipërisë, duke filluar nga MSA me BE-në, CEFTA etj.

c) Propozim në lidhje me njohjen e pullave fiskale që shkatërrohen nga makineritë në procesin e vendosjes tek produkti

Lidhur me ndryshimet në ligjin “Për Akcizat” propozojmë që tek Neni 41 “Aplikimi i pullave fiskale” të shtohet paragrafi 9 me përmbajtjen që vijon:
Pas pikës 8, shtohet pika 9 me përmbajtjen që vijon:

“9. Pullat fiskale që shkatërrohen plotësisht nga makineritë gjatë procesit të vendosjes tek produktet, do të njihen bazuar në deklarin e prodhuesit të mallrave të akcizës që bën vendosjen e pullave, por jo më shumë se 0,5 % e sasisë vjetore të pullave të përdorura. Deklarata faktike për firot e pakthyeshme të pullave që shkatërrohen plotësisht nga makineritë dhe nuk mund ti kthehen fizikisht organeve doganore hartohet nga prodhuesit e mallrave që bëjnë vendosjen e pullave dhe duhet të depozitohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave brenda datës 31 Mars të çdo viti për vitin e mëparshëm kalendarik. Operatorët që furnizohen nga disa fabrika prodhuese jashtë vendit duhet të bëjnë një deklaratë përmbledhëse vjetore, e cila paraqitet nga operatori në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave brenda datës 31 Mars të çdo viti për vitin e mëparshëm kalendarik.

Për këtë sasi pullash që shkatërrohen plotësisht nga makineritë nuk ka detyrim akcize dhe as gjoba.

Pullat e akcizës të shkatërruara plotësisht nga makineritë llogariten si vijon: gjendja e pullave në fillim të vitit + furnizimet gjatë vitit - pullat e vendosura në produktet e akcizës gjatë vitit - pullat e kthyer gjatë vitit për t'u asgjësuar me prezencën e organeve doganore - gjendjen në fund të vitit.

Çdo humbje apo dëmtim tjetër që i bën pullat e akcizës të papërdorëshme do të provohet dhe trajtohet në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij Ligji.”

Propozimi si më sipër synon të trajtojë pullat fiskale që shkatërrohen plotësisht gjatë procesit të vendosjes automatike nga makineritë prodhuese dhe ambalazhuese të produkteve të akcizës, siç janë makineritë e paketimit të cigareve apo pijeve alkoolike dhe që bëjnë edhe vendosjen automatike të pullave fiskale. Për shkak të proceseve shumë të shpejta të makinerive të paketimit të produkteve të akcizës dhe vendosjes së pullave fiskale, një pjesë shumë e vogël e pullave shkatërrohen plotësisht (duke u transformuar në grimca shumë vogla apo pluhur) dhe nuk mund të rikuperohen. Bazuar në legjislacionet dhe praktikën ndërkombëtare kjo sasi varion mesatarisht 0,3% – 1% të sasisë së pullave të përdorura. Këto humbje të pakthyeshme të pullave fiskale për shkak të makinerive të prodhimit dhe vendosjes, zakonisht njihen automatikisht ose kërkojnë një deklarin nga prodhuesit që bëjnë vendosjen e pullave.

Në rastin tonë kërkojmë të saksionohet njohja e një niveli të pullave të shkatërruara plotësisht nga makineritë deri në 0,5% të pullave të përdorura gjatë vitit, bazuar në deklaratën e operatorit që bën prodhimin e mallrave të akcizës dhe vendosjen e pullave.

Gjithashtu, për të adresuar efektet nga propozimi si më sipër (në nenin 41 të ligjit) propozojmë që nenin 90, të bëhet një shtesë mbi propozimin e bërë nga qeveria (shtesa e propozuar është me ngjyre më të errët):

Neni 90, Pika 10, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“10. Tepricat ose mangësitë në pulla fiskale, të konstatuara gjatë kontrollit të magazinave fiskale dhe të pa justifikuar nga operatori sipas dispozitave në fuqi, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë nga 20.000 lekë deri në 50.000 lekë në varësi të rasteve të përsëritura. Pagesa e gjobës, në asnjë rast nuk shmang shkelësin nga pagimi i detyrimit të munguar të akcizës, për sasinë e pullave me diferencë”.

3. Projektligji “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014, ‘Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar”

a) Heqja e disa përjashtimeve nga TVSH.

Lidhur me heqjen e përjashtimeve nga TVSH-ja, na duket shqetësuese mënyra e vendimmarrjes dhe arsyetimi i vakët i paraqitur që këto përjashtime (a) nuk janë në përputhje me Direktivën Europiane të TVSH dhe (b) nuk mbështeten mbi një argumentim të shëndoshë, pasi kuptohet që në momentin kur u vendosën duhet të kishte një arsyetim të shëndoshë.

Nuk vërejmë në relacionin shoqërues asnjë analizë mbi qëllimet fillestare të vendosjes së përjashtimit, vërejtjet nga zbatimi në praktikë gjatë këtyre viteve, ndonjë shenjë diskutimi paraprak me palët e prekura e grupet e interesit, arsytet konkrete të heqjes së tanishme, ndonjë masë për lehtësim apo asistencë ndaj palëve të prekura që kishin të ndërtuar një plan biznesi bazuar mbi këtë përjashtim dhe që tashmë ndikohen negativisht në gjendjen e cash-it dhe nevojat për financim etj.’

Nëse ministria synon harmonizimin e legjislacionit tonë me atë Europian, të njësojë të gjitha përjashtimet në Shqipëri me ato të Direktivës së TVSH dhe të mos japë asnjë përjashtim të ri. Aktualisht, qeveria jep dhe heq përjashtime bazuar në nevoja të castit dhe pa një program të qartë se çfarë synohet të arrihet.

b) Projektligji propozon që në nenin 56 “Përjashtime të veçanta në import”, të bëhen ndryshimet si më poshtë: Në pikën 38, shkronja a), togfjalëshi “...50 milionë lekë;” zëvendësohet me togfjalëshin “...500 milionë lekë;”. Në pikën 38, shkronja c) “importimi i makinerive prodhuese nga subjektet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.” të shfuqizohet.

Relacioni shprehet se ky ndryshim ka ardhur si rrjedhojë e rritjes së qasjes së investitorëve të huaj për të kryer investime madhore në disa zona strategjike në vendin tonë. Qëllimi kryesor i këtij propozimi është tërheqja e investitorëve të huaj dhe përthithja e investimeve madhore, të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike të vendit dhe modernizimin e tij.

Në fakt më shumë se për të tërhequr investime madhore ky ndryshim përjashton tashmë investimet me vlerë nën 500 milionë lekë, lidhur me përjashtimin nga TVSH-ja në import të makinerive dhe pajisjeve që importohen në funksion të realizimit të kontratave të investimeve. Ndërkohë, siç është



e shkruar aktualisht në ligj neni 56, pika 38/a, i përfshin edhe investimet madhore me vlerë 500 milionë lekë, pasi parashikon investime me vlerë të barabartë ose më të madhe se 50 milionë lekë. Ndaj qëllimi i këtij ndryshimi nuk ka kuptim, përveçse ka karakter përjashtues për shumë investitorë nga ato “incentiva” të pakta që ka në fushën tatimore në Shqipëri.


Ky propozim do të bënte që incentiva e përjashtimit nga TVSH të aplikohet vetëm për investime shumë të mëdha (që në fund të fundit kanë edhe më shumë likuiditet për të përballuar pagimin e TVSH në doganë dhe më tej rimbursimin e TVSH kreditore me plotësimin e kushteve ligjore), ndërkohë që penalizon investime më të vogla, që kanë më shumë nevoja likuiditeti dhe nuk kanë akses në administratën tatimore për të përfituar rimbursimin në kohë të TVSH kreditore.

c) Projektligji propozon që në nenin 148 “Norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor”, togfjalëshi “...6 për qind.” zëvendësohet me togfjalëshin “...0 për qind.”.

Aktualisht industria e përpunimit është e disfavorizuar, sepse ka pasur TVSH 6% në blerje dhe 20% TVSH në shitje, ndërsa ky ndryshim dëmton akoma më shumë industrinë e përpunimit dhe vecanërisht industrinë e përpunimit të qumështit.

Skema e re e propozuar - me 0% në blerje dhe 20% në shitje - deformon rëndë parimin e pagesës së Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, pasi operatori ndërmjetës përveç 20% Tatim mbi Vlerën e Shtuar që ai i shton produktit duhet të paguajë edhe 20% të vlerës së krijuar nga një operator tjetër (fermeri informal) para tij.

Zgjidhja e vetme në këtë rast do të ishte implementimi i skemës së TVSH për produktet ushqimore (blegtorale/bujqësore), sic e ka rajoni, me një TVSH në shitje 5-7%. **Norma prej 20% e TVSH** është shumë e lartë për industrinë e grumbullimit dhe përpunimit të qumështit dhe aspak favorizuese,



kundrejt eksperiencave të vendeve të tjera në rajon dhe Evropë, të cilët aplikojnë TVSH nga 5-7% për produktet bazë ushqimore, përfshirë sektorin e qumështit.



Ndërkohë për të mbështetur fermerin, duhet rritja e buxhetit për skemën kombëtare dhe subvencionimin direkt të fermerëve sipas modelit të rajonit, konkretisht sipas modelit të Maqedonisë së Veriut. Kjo skemë mbështetje duhet të përfshijë patjetër:

- Rimbursim i fermerëve sipas sasisë së prodhuar të qumështit, 10 lekë për çdo litër qumësht të dorëzuar në pikat e licencuara të grumbullimit ose fabrikat e përpunimit të qumështit. Kjo skemë mbështetëse duhet të jetë pa limit, në mënyrë që çdo fermer/fermë ta përfitojë subvencionin për çdo litër qumësht të prodhuar, njëlloj si në rajon.
- Rimbursimi i fermerëve/fermave për numrin e krrerëve dhe për çdo lindje të re.
- Rimbursimi i fermerëve/fermave për sipërfaqen e tokës së mbjellë për ushqim për blegtorinë (konkretisht për jonxhë, misër, grurë, silazh, etj).
- Politika nxitëse dhe subvencionuese për ferma nga skemat kombëtare (jo IPARD).

4. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 ‘Për Taksat Kombëtare’, i ndryshuar”

- a) Projektligji propozon që në nenin 3 “Llojet e taksave kombëtare” të shtohet pika 12 me këtë përmbajtje: **“12. Taksë për importimin ose prodhimin e qumështit pluhur (për produktin e importuar sipas kodeve të NKM-së 04021019 dhe 04022118 në vlerën 100 lekë për kg)”**.

Argumenti i përdorur në relacionin shoqërues në lidhje me qumështin pluhur është i pasaktë. Aty thuhet se kjo taksë “do të incentivojë prodhimin dhe tregtimin në vend të qumështit, me synim mbështetjen e fermerëve vendas. Kjo, duke marrë në konsideratë dhe faktin se sektori i qumështit konsiderohet si sektor me përparësi nisur nga potenciali për zëvendësimin e importit”.

Ndërkohë që taksimi i qumështit pluhur nuk lidhet aspakt me prodhimin e qumështit të fermerëve sepse qumështi pluhur që hynë në Shqipëri, shumë pak përdoret nga industria e përpunimit të qumështit dhe më shumë përdoret nga industritë e tjera ushqimore (pasticeritë, prodhimi biskotave, etj). Gjithashtu dhe atë pjesë që përdor industria e përpunimit të qumështit, e përdor në produkte të miratuara me etiketë nga AKU dhe të certifikuara si kartelë teknologjike për prodhim. Ndërkohë, kjo masë dëmton akoma më shumë përpunuesin vendas, sepse ndërkohë që taksojmë qumështin pluhur si lëndë të parë, nuk taksojmë asnjë produkt tjetër importi që prodhohet nga qumështi pluhur.

Është krijuar paragjykimi për përdorimin e qumështit pluhur. Evropa krenohet me prodhimin dhe tregtimin e qumështit pluhur. Është një lëndë e parë që përdoret qoftë në receptura të ndryshme, si edhe në periudha mungese qumështi për të përmbushur nevojat e tregut. Nëse qeveria po përdor si argument faktin që qumështi pluhur po dëmton industrinë dhe fermerët, mund të japim argumenta të tjerë se ka shumë arsye të tjera që e dëmtojnë sektorin. Qumështi pluhur që është importuar në Shqipëri në vitin 2020 (nga të dhënat e doganës) është rreth 1,100 ton (me dhe pa yndyrë). Nëse supozojmë se gjithë kjo sasi qumështi pluhur është përdorur në industrinë e qumështit (që nuk është e vërtetë pasi përdoret edhe për pastičeritë) ekuivalenti i qumështit i prodhuar nga qumështi pluhur është 10-11 mijë ton qumësht. Nga importi, qumësht i paketuar për tregtim ka hyrë mbi 12 mijë ton gjatë vitit 2020. A nuk është ky qumësht njëlloj dëmtues për industrinë dhe fermerët? Pse nuk taksohet njëlloj si qumështi pluhur? Qeveria propozon jo vetëm të taksojë importin por edhe prodhimin, që nënkupton nëse një nga kompanitë dëshiron të investojë në linjë për dehidratim qumështi (tepricat) dhe tregtim si lëndë e para qumësht pluhur, kjo initiative e qeverisë e dekurajon industrinë.

- b) Projektligji propozon që në nenin 3 “Llojet e taksave kombëtare” të shtohet pika 13 me këtë përmbajtje: **13. Taksë për karburantin në zonat e lira doganore dhe magazinat doganore që**



përdoret për furnizimin e mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtim, të përcaktuara sipas ligjit "Për aktivitetet e turizmit detar në vlerën 65 lekë/litër".

Furnizimi i mjeteve lundruese ka lidhje me aktivitetin në zonat e lira ose magazinat e lira doganore.

Ky lloj aktiviteti është i destinuar të mbyllet nëse aplikohet taksa prej 65 lekë/litër, pasi nuk do të jetë më konkurrues me tregun ndërkombëtar. Produkti që shteti kërkon të taksojë hyn në Shqipëri pa taksë dhe del përsëri po ashtu si ri-export. Nëse deri më tani, shteti mblidhte tatim fitimi apo tatim mbi pagat nga ky lloj aktiviteti, pas vendosjes së taksës nuk do të ketë me interes nga mjetet lundruese për furnizim në Shqipëri dhe rrjedhimisht aktiviteti do të mbyllet tërësisht.

SEKSIONI II

5. Propozime të tjera

a) Ligji "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar" sa i takon taksës së plastikës

Duke marrë shkas nga ndryshimet e bëra në paketën e re fiskale në ligjin për taksat kombëtare të miratuar në qeveri për taksimin e qumështit pluhur me 100 Lekë/kg, si për prodhimin vendas ashtu edhe për produktin e importuar, duhet të kërkojmë që e njëjta logjike të ndiqet edhe me taksën kombëtare të plastikës e cila është e diferencuar 10 Lekë/kg për prodhuesit vendas (kur importojnë lendën e parë granulat) dhe 35 Lekë/kg për importuesit e produktit të gatshëm.

Analogjia me taksimin e produktit qumësht pluhur është shumë e mirë dhe mendojmë mund të shfrytëzohet për unifikimin e taksës edhe tek plastika, e cila po shkakton dëme tek importuesit e plastikës dhe ndërkohë nuk ka sjellë ndonjë efekt në lidhje me promovimin e biznesit vendas. Pra në fund të ditës taksohet produkti, njësoj, si për prodhuesit vendas ashtu edhe për importuesit. Edhe në këtë kemi kërkuar, unifikimin e taksës së plastikës, si për prodhuesit vendas ashtu edhe për importuesit.

Taksimi i bëhet produktit të plastikës dhe pasojat duhet të bien mbi produktin, jo mbi operatorët duke i diferencuar dhe vendosur ata në kushte të pabarabarta në treg. E drejta e të qenit në kushte të barabarta në treg është një e drejtë themelore dhe kështu ka qënë përpara miratimit të ligjit bashkëngjitur me taksë të diferencuar.

b) Ligji "Për TVSH" dhe ligji "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Propozojmë që të ndryshohen afatet për lëshimin e faturave të fiskalizuara dhe deklarimeve të TVSH si vijon:

- Lëshimi i faturave të lejohet deri në datën 10 të çdo muaji për muajin paraardhës (siç është aktualisht);
- Ngarkimi i Librave të TVSH në "Self care" të mundësohet deri në datën 15, pasi është e pamundur të bëhen rregullimet në libra për faturat e blerjes brenda datës 10, kur edhe faturat mund të merren në po atë datë. Pra mund të marrësh një ose disa fatura blerje pasditen e datës 10 dhe e ke të pamundur të besh rregullimet në Librin e Blerjes;
- Deklarimi dhe pagesa e TVSH të bëhen brenda datës 20 të çdo muaji. Kjo ul edhe barrën administrative të tatimpaguesve, pasi i bëjnë njëherësh të gjitha pagesat (sigurime, TAP, tatim në burim, TVSH brenda datës 20).

c) Ndryshime në Ligjin për Procedurat Tatimore lidhur me afatin e zbatimit të gjobave lidhur me procesin e fiskalizimit

Pavarësisht se Ligji i Procedurave Tatimore nuk është përfshirë në paketën e propozuar për vitin 2022, jemi të mendimit që është i nevojshëm një ndryshim i këtij ligji lidhur me afatin e aplikimit të gjobave për procesin e fiskalizimit. Duke pasur parasysh ecurinë e deritanishme dhe problematikat (siç listohen në pikën d me poshtë) do të propozojmë që afati për zbatimin e plote të ligjit të shtyhet deri në fund të vitit 2022. Kjo do të bënte të mundur:

- Arritjen nga administrata të vënies në funksion 100% të Platformës Qendrore të Faturave, pasi në gjendjen aktuale veprimet që bëhen në platformë janë shumë të ngadalta dhe me gabime të shpeshta për shkak të përditësimeve të vazhdueshme.
- AKSHI nuk ka pajisur me certifikata elektronike një pjesë të madhe të tatimpaguesve pavarësisht kryerjes së aplikimit dhe pagesës.
- Hyrjen në proces të pjesës më të madhe apo të gjithë tatimpaguesve që kanë detyrim për të lëshuar fatura.
- Zgjidhjen e një numri të madh problematikash që hasen në baza ditore nga përdorimi i Platformës Qendrore të Faturave dhe sistemeve të faturimit.
- Përshtatjen ndërkohë të e bazës ligjore aktuale të tatimit mbi vlerën e shtuar apo ligjeve të tjera të cilat ndikojnë në zbatimin korrekt të ligjit “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

d) Problematika lidhur me zbatimin e ligjit “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

- 1) **Hyrja në Platformën Qendrore të Faturave** – Hyrja në platformë bëhet me kredencialet që biznesi hyn në portalin e-albania dhe nuk ka nivele aksesit për përdorues të ndryshëm. Informacioni që mund të merret nga përdoruesi që hyn dhe në platformën qendrore të faturave është konfidencial apo i kufizuar vetëm për persona të autorizuar në kompani (si p.sh. listëpagesat, lejet, vërtetime, etj.)

Propozim: Është e detyrueshme dhe e domosdoshme të ndahen nivelet e aksesit siç janë për e-tax apo portale të tjera, pasi kjo mënyrë konfigurimi dhe aksesit mund të dëmtoje dhe të sjellë pasoja për keqpërdorimin e të dhënave personale apo dhe të shoqërive.

- 2) **Standardizimi i librave të blerjes dhe të shitjes** - Formatit i transaksioneve mujore që del nga Platforma Qendrore e Faturimit është shumë i ndryshëm nga formati i librave të blerjes dhe të shitjes që përdoren aktualisht në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr. 92/2014 Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimit Nr. 6 datë 30.01.2015.

Rekomandim - të unifikohen raportet mujore të shitjes dhe të blerjes që dalin nga Platforma Qendrore e Faturimit.

- 3) **Shtyrje e afatit të plotësimit të librave të TVSH** - Në ligjin aktual të TVSH por dhe të Ligjit “Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit” për një sërë transaksionesh fatura mund të lëshohet deri në datën 10 të periudhës pasardhëse. Ndërkohë data 10 e muajit pasardhës është dhe data e fundit e deklarimit të librave të blerjes dhe të shitjes. Mund të ndodhe që faturat të lëshohen në datën e fundit të lejuar pra data 10 që është e njëjtë dhe me afatin e fundit të raportimit të librave.

Rekomandim: Nëse është e mundur të ndryshohet data e raportimit të librave të TVSH dhe të jetë në një datë me atë të dorëzimit të deklaratës së TVSH, pra data 14. Kjo do ti jepte më shumë hapësire tatimpaguesve për të raportuar saktë dhe të mos bëjnë korrigjime në librat e blerjes dhe të shitjes.

- 4) **Kreditimi i TVSH së faturave të lëshuara nga blloku brenda periudhës 12-mujore dhe lëshimi i faturës korrigjuese për to** - Për fatura të periudhave të mëparshme për të cilat nuk ka qenë detyrim fiskalizimi dhe që janë brenda 12 periudhave tatimore, duket se teknisht është e pamundur të deklarohet dhe të zbritet TVSH-ja.

Rekomandim: ka nevojë për udhëzime apo ndërhyrje në Platformën Qendrore të Faturimit për të lejuar fiskalizimin e faturave të lëshuara më parë me bllok në rast se këto deklarohen në një kohë të mëvonshme apo ka nevojë për të bere korrigjimin e tyre.

- 5) **Fiskalizimi i importeve** - Fiskalizimi i importeve ka krijuar shume vështirësi praktike në saktësimin e vlerës së tatueshme apo të TVSH-së që është paguar përmes deklaratës që po fiskalizohet. Vështirësia rritet ose në disa raste bëhet krejtësisht e pamundur të fiskalizohen disa deklarata të veçanta importi.

Rekomandim: Kërkohen ndryshime ligjore dhe nënligjore për të cilësuar se fiskalizimi i importeve duhet të kryhet vetëm për të cilësuar furnizuesin e huaj. Të përshtatet platforma e faturimit dhe të mos lejohen prekje të vlerës së tatueshme dhe TVSH-së së deklaratës doganore të importit. Përcaktimi i vlerës së tatueshme dhe TVSH-së së deklaratës doganore të importit të mbetet në kompetencën e autoriteteve doganore dhe çdo pasaktësi të zgjidhet sipas dispozitave të Kodit Doganor dhe Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor.

- 6) **Shënime të tjera në faturë** – Formati i faturës ka kufizim në karaktere dhe nuk lejon shtimin e përshkrimeve që mund të kërkohen dhe nga ligji. Deri tani platforma self-care dhe zgjidhjet softëare-ike nuk kanë mundësuar fusha specifike ku të mund të vendosen shënime të veçanta referuar nenit të posaçëm të Ligjit të TVSH-së, kur fatura lëshohet e përjashtuar nga TVSH, pa TVSH apo raste të tjera sipas Ligjit.

Rekomandim: Kërkohen përshtatje në platformën self-care dhe zgjidhjet programimi për të vendosur fushë të veçantë ku të mund të reflektohen shënimet përkatëse sipas Ligjit të TVSH-së.

- 7) **Operatorët** - Operatorët nuk mund të regjistrohen në Platformën Qendrore të Faturave nëse ju ka skaduar letërnjoftimi (karta e identitetit) apo nëse janë shtetas të huaj të deklaruar në listëpagesë por që nuk janë në regjistrin e gjendjes civile. Një problematikë tjetër është se nuk është e qartë se si ndryshohen datat efektive të aksesit të operatorëve pasi ikonat në platforme nuk lejojnë modifikimin.

Rekomandim: të konfigurohet platforma që të pranojë regjistrimin e operatorëve dhe pse mund të ketë skaduar letërnjoftimi. Numri personal i individëve shqiptarë nuk ndryshon pavarësisht se mjeti aktual i identifikimit mund të ketë skaduar. Të shihet mundësia e lejimit të regjistrimit të operatorëve me të dhënat që janë raportuar në listëpagesë. të sqarohet me ligj/udhëzim se si duhet të regjistrohen individët e huaj (që janë në listëpagesë) por që nuk janë në regjistrin e gjendjes civile.

Te merren masa që ikonat në platformë të aktivizohen dhe të punojnë rregullisht që të lejohen ndryshime të mundshme sipas nevojave të biznesit.